

Tiranë më 30.10.2019

Bashkimi Evropian
Instrumenti për ndihmën Para- Anëtarësimit
Për Zhvillimin Rural – IPARD

NJOFTIM

Përsa i përket thirrjes së dytë të programit IPARD II, e cila është hapur më datë 30 Tetor 2019 deri në 16 Dhjetor 2019 ju njoftojme se:

- Kategoria minimale e lejuar për motorrët e traktorëve duhet të jetë dhe IIIA për motorrët nën 37 kW dhe të paktën IIIB për motorrët me fuqi më të madhe ose të barabartë me 37 kW.

Të gjithë investimet për traktorë duhet të plotësojnë standardet referuar bazës ligjore më poshtë:

- Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 985 e datës 12 Shkurt 2018, që plotëson Rregulloren (BE) Nr. 167/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me kërkesat mjedisore për automjetet bujqësore dhe pyjore dhe motorët e tyre dhe shfuqizues i Rregullores së Komisionit (BE) 2015/96;
- Rregullore (BE) 2016/1628 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 shtator 2016 për kërkesat në lidhje me kufijtë e emetimit të ndotësve të gaztë dhe grimcave dhe miratimin e tipit për motorrët me djegie të brendshme për makineri lëvizëse jo- rrugore, duke ndryshuar rregulloret (BE) Nr 1024/2012 dhe (BE) Nr 167/2013, dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e Direktivës 97/68 / EC;
- Ligji nr. 37/2015 Për ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare te BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit (IPA II);
- Marrëveshje Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare te BE-së për Republikën e Shqipërisë në kuadër te instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit në fushën "Bujqësia dhe zhvillimi rural" (IPARD);
- Legjislacioni mjedisor përfshirë marrëveshjet shumëpalëshe të mjedisit, si dhe standardet themelore të punës të njohura ndërkombëtarisht.